



PARTIA EGJIPTIANE - IRDK

P R O G R A M I

Përmbajtja

Parimet Programore	3
Sistemi Demokratik	3
Ekonomia e tregut.....	4
Mbrojtja dhe përmirësimi i ambientit	5
Bashkëpunimi me diasporën.....	5
Toleranca, marrëdhëniet ndër njerëzore dhe emancipimi i gruas	5
Të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve	6
Rinia, Arsimi, Kultura dhe Sporti.....	6
Mbrojtja sociale dhe politika shëndetësore	7

Parimet Programore

PARTIA EGJIPTIANE është pasuese e Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës - IRDK e cila ishte krijuar në një realitet të ri të Kosovës, pas vendosjes së forcave ndërkombëtare dhe fillimit të funksionimit të institucioneve demokratike të Kosovës.

Synon afirmimin dhe sendërtimin e një shoqërie moderne të një sistemi demokratik të sprovuar në Evropën Perëndimore.

PARTIA EGJIPTIANE mendon se në këto momente duhet të arrihet një bashkim i mendimit politik e demokratik të të gjithë kosovarët për ndërtimin e një Kosove Demokratike dhe multietnike.

PARTIA EGJIPTIANE dëshiron që Kosova të udhëhiqet në parime të barazisë qytetare, të tolerancës dhe solidaritetit të të gjithë qytetarët e Kosovës.

PARTIA EGJIPTIANE duke pasur parasysh situatën e krijuar pas luftës në Kosovë, si parim do të kemi çështjen e të zhvendosurve nga Kosova, që do të thotë kthimin e të gjithë të pafajshmeve dhe mundësinë e ndërtimit të shtëpive të dëmtuara të të gjitha kategorive.

PARTIA EGJIPTIANE synon sistemin demokratik pluralist, pra të gjitha partitë kosovare të synojnë ligjshmërinë, formimin e institucioneve të një shteti civil, garancitë më të larta për liritë dhe të drejtat e njeriut, barazinë e femrës, mbrojtjen institucionale dhe integrimin e minoriteteve në shoqërinë kosovare, duke u bazuar në standardet më të larta që dalin nga konventat ndërkombëtare.

PARTIA EGJIPTIANE synon emancipimin politik, ekonomik dhe shoqëror të të gjithë qytetarët, zhvillimin e humanizmit dhe të solidaritetit si kategori e shoqërisë civile, dhe në veçanti emancipimin e gruas dhe të familjes si celulë shoqërore, mirëkuptimi, liria, paqja, dhe solidariteti janë synim i programit të PARTIA EGJIPTIANE.

Të gjitha synimet programore, PARTIA EGJIPTIANE do të angazhohet ti jetësoj me mjete demokratike e paqësore të cilat janë të pranuar për Evropën Perëndimore.

Sistemi Demokratik

Në sistemin demokratik të të gjithë qytetarët dhe subjektet politike kanë përgjegjësi ndaj institucioneve demokratike dhe vlerave më të larta civilizuese.

Prandaj PARTIA EGJIPTIANE synon të ndërtoj sistemin demokratik ku në shtetin juridik pushteti do të organizohet mbi parimin e ndarjes së pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe

gjyqësor, ndërsa ekonomia, policia, armata, administrata dhe informimi të jenë të depolitizuar.

Në kuadrin regjional PARTIA EGJIPTIANE përkrah forcat politike që kanë për qëllim demokratizimin e Kosovës dhe Ballkanit, kur kemi parasysh këtë thënie duhet të kuptojmë se një politikë e shtypjes dhe e diskriminimit racor e fetar, kanë sjell politiken e konflikteve që kanë destabilizuar tërë Ballkanin, pra PARTIA EGJIPTIANE do të synoj që Kosova të jetojë në paqe e demokraci me të gjitha shtetet Ballkanike dhe Evropiane.

PARTIA EGJIPTIANE përkrah reformat institucionale evropiane dhe synon që Kosova si pjesë e Evropës t'i bashkëngjitet forcave politike të saj që synojnë integrimin e popujve të kontinentit tonë në një Evropë politike dhe ekonomike, sepse vetëm një Evropë e bashkuar demokratike, ku respektohen veçoritë e secilit popull dhe integrimi përmes tolerancës dhe solidaritetit, bëhet realitet për dhënien fund të konflikteve.

PARTIA EGJIPTIANE pranon organizimin e lirë, veprimet sindikale dhe të drejtën për grevë si dhe besimet fetare që janë të drejta elementare të njeriut. PARTIA EGJIPTIANE është për respektimin e pushtetit legal të zgjedhur në zgjedhjet e lira shumë partiake.

Ekonomia e tregut

PARTIA EGJIPTIANE angazhohet për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të Kosovës të bazuar në ligjet e ekonomisë së tregut, të hapur e të lirë, shfrytëzimin racional dhe intensiv të resurseve natyrore e njerëzore dhe të integruar në institucionet rajonale dhe euro atlantike. PARTIA EGJIPTIANE gjatë fazës tranzitore do të bëjë përpjekje maksimale ti sanoj pasojat e luftës dhe të zvogëloj prapambetjen ekonomike të Kosovës në raport me Evropën Perëndimore.

Zhvillimi dinamik dhe i sinkronizuar ekonomik në Kosovë, si në fazën tranzitore ashtu edhe në vijim, duhet të mbështetet në këto drejtime themelore ekonomike:

Rikonstruktimin dhe ndërtimin e infrastrukturës themelore ekonomike
Privatizimin e pronës shoqërore me një shpejtësi të duhur

Zhvillimin e hovshëm të ekonomisë dhe angazhimin në Paktin e Stabilitetit për Evropën juglindore që donatoreve dhe investitorëve të jashtëm t'u lehtësoj rrugën e realizimit të projekteve që kanë të bëjnë me Kosovën

Zhvillimin e sistemit edukativ në lëmin e shkencave ekonomike për përgatitjen profesionale konform nevojave të tregut kosovar

Mbrojtja dhe përmirësimi i ambientit

PARTIA EGJIPTIANE do të angazhohet për ruajtjen e ambientit jetësor ekologjik, si një nga parakushtet elementare për zhvillim të shëndosh fizik dhe intelektual të njeriut.

PARTIA EGJIPTIANE do të mbështet uljen e taksave për teknologjinë bashkëkohore që nuk benë ndotje e ambientit dhe do të insistoj kundër investimeve që rrënojnë ambientin jetësor. Orientimi dhe aktiviteti i përhershëm i PARTIA EGJIPTIANE është mbrojtja e ujit, ajrit, tokës nga çdo lloj ndotje.

PARTIA EGJIPTIANE do të angazhohet për planifikimin hapësinor, jetësimin e planit urbanistik si dhe mbrojtjen e pyjeve dhe parqeve nacionale. PARTIA EGJIPTIANE do të mbështesë çdo iniciativë të qytetareve dhe aksionet për mbrojtjen e ambientit jetësor.

Bashkëpunimi me diasporën

PARTIA EGJIPTIANE angazhohet për dialog dhe bashkëpunim me të gjitha partitë, organizatat, shoqatat dhe lëvizjet demokratike të Kosovës, diasporës dhe më gjerë.

PARTIA EGJIPTIANE angazhohet për inkuadrimin sa më të shpejtë të Kosovës në proceset integruese të Evropës, duke u bërë kështu pjesë e pandashme e zhvillimit dhe civilizimit evropian ku Kosova duhet të ketë vendin.

PARTIA EGJIPTIANE do të angazhohet dhe do ta ketë si preokupim të përhershëm çështjen e Diasporës për arsye se migrimet janë procese afatgjatë të lëvizjes së njerëzve.

PARTIA EGJIPTIANE do të angazhohet për kontakte sistematike me qytetarët jashtë atdheut në mënyrë të organizuar dhe institucionale. Angazhohet për zhvillimin e formave të lidhjeve që janë në funksion të njohjeve dhe të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe vendeve ku jetojnë dhe punojnë bashkëkombësit tonë.

PARTIA EGJIPTIANE angazhohet për krijimin e parakushteve për kthimin e atyre që duan të kthehen, për riatdhesimin dhe ri integrimin e tyre në shoqërinë kosovare.

Toleranca, marrëdhëniet ndër njerëzore dhe emancipimi i gruas

PARTIA EGJIPTIANE angazhohet për barazinë e të gjithë qytetareve para ligjit pa marrë parasysh përkatësinë e tyre nacionale, fetare, racore dhe garanton të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare në pajtim me standardet më të larta që dalin nga konventat ndërkombëtare.

PARTIA EGJIPTIANE si parti e re ka për synim emancipimin politik, ekonomik dhe shoqëror të të gjithë qytetarët, zhvillimin e humanizmit dhe të solidaritetit, e në veçanti emancipimin dhe edukimin e gruas dhe të familjes si celulë e shoqërisë.

PARTIA EGJIPTIANE vlerëson lartë rolin e gruas kosovare në çdo sferë të jetës, prandaj do të luftoj kundër çdo forme të diskriminimit të gruas, kundër tregtisë me gratë dhe kundër prostitucionit.

Të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve

PARTIA EGJIPTIANE do të angazhohet për një Kosovë demokratike që siguron realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në përputhje me deklaratën universale të OKB-së.

PARTIA EGJIPTIANE do të angazhohet që fëmijëve të Kosovës pa dallim të përkatësisë etnike, fetare, gjinore apo racore që të iu siguroj një jetë më të lumtur dhe më me perspektivë.

PARTIA EGJIPTIANE do të angazhohet që fëmijëve t'ju sigurohen mbrojtja sociale për zhvillimin normal psiko-fizik dhe që fëmijët t'i gëzojnë të drejtën e arsimit fillor falas. Kujdes i veçantë do ti kushtohet angazhimit që ti ndaloj çdo veprimtari jo njerëzore me fëmijët: eksploatimin, tregtinë, punën etj., që janë në dem të fëmijëve.

Rinia, Arsimi, Kultura dhe Sporti

Pasi që në çdo vend rinia është shtylla kryesore dhe forcë e shoqërisë demokratike, ne si parti do ti kushtojmë shumë kujdes. Prandaj PARTIA EGJIPTIANE do të mbështes rininë në arsim, punësim, edukim, sport, pra integrimin në jetën politike e shoqërore të Kosovës.

PARTIA EGJIPTIANE do ti kushtoj rendësi të veçantë ngritjes profesionale dhe specializimin e rinisë në botën e jashtme. Objektivat e politikës në sferën e kulturës, arsimit, sportit do të jetë krijimi i individualitetit të lirë, ngritjen e kreativitetit dhe të përgjegjësisë kolektive e individuale, të ndërtimit dhe përparimit të një shoqërie tolerante dhe humane. Ne do të favorizojmë një zhvillim të gjithanshëm kulturor, dhe angazhohemi për ruajtjen, kultivimin, pasurimin dhe përhapjen e kulturës sonë kombëtare.

PARTIA EGJIPTIANE do të angazhohet për simpoziume shkencore të identitetit kombëtar në mënyrë që të kemi të drejtën tonë kombëtare dhe historike.

Të gjitha institucionet arsimore, kulturore dhe sportive duhet të jenë autonome dhe profesionale. Sa i përket shkollimit fillor duhet të jetë obligativ ndërsa përgatitjet e mesme dhe superiore duhet të zhvillohen sipas nevojave dhe mundësive shoqërore dhe sipas interesave individuale.

PARTIA EGJIPTIANE do të angazhohet për reformimin rrënjësor të sistemit shkollor, të plan programeve mësimore të cilat duhet të hartohen sipas standardeve më të larta shkencore dhe civilizuese.

PARTIA EGJIPTIANE angazhohet për një bashkëpunim kulturor kombëtar dhe ndërkombëtar për arritjen e këtyre qëllimeve:

Të shpërndaj njohuritë e të stimuloj begatinë kulturore

Të zhvilloj marrëdhënie paqësore dhe të miqësisë në mes të popujve
Bashkëpunimi kulturor dhe sportive dhe edukimi moral dhe intelektual të rinia në një frymë të miqësisë, të mirëkuptimit, paqes dhe tolerancës do të jetë përkushtim i vazhdueshëm i PARTIA EGJIPTIANE.

Mbrojtja sociale dhe politika shëndetësore

PARTIA EGJIPTIANE ka për qëllim mbrojtjen e shtresave më të varfra të shoqërisë kosovare në mënyrë të veçantë familjet e invalidëve, dëshmoreve, dhe të pa punësuarve.

PARTIA EGJIPTIANE angazhohet për të siguruar të gjithë pensionistëve të drejtën në pension, shfrytëzimin e kësaj të drejte universale, sociale e njerëzore.

Sa i përket politikës shëndetësore, do të angazhohemi për ruajtjen e shëndetit të të gjithë qytetareve, për krijimin e një shoqërie të shëndosh kosovare.

PARTIA EGJIPTIANE posaçërisht do të angazhohet për:

Planifikimin shëndetësor të mbështetur na parimet e solidaritetit, të interesave shoqërore dhe ekonomike

Mbrojtjen shëndetësore dhe sociale për të hendikepuarit dhe individëve me sëmundje tjera të rënda

Mbrojtjen e atyre që presin punë dhe atyre që janë larguar nga puna

Të drejtën e kthimit në punë të gjithë atyre që padrejtësisht janë larguar nga puna dhe njohjen e stazhit të punës

Garantimin e pagave të punësuarve që ajo pagë të siguroj një nivel të domosdoshëm të standardit jetësor

Programi i partisë sonë në të ardhme do të plotësohet dhe pasurohet edhe më tej sipas kërkesave të aderuesve të PARTIA EGJIPTIANE.